

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE

BULETINI M U J O R I

PRILL 2026



► ***Për herë të parë, dyfishohen pagesat për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të njihen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për kujdestarët***

Qeveria shqiptare do të dyfishojë pagesën mujore për 11 mijë fëmijë me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me spektër autizmi, fëmijët e verbër, tetraparaplegjikë dhe fëmijët me sindromën Down, si dhe për herë të parë do të njihen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për rreth 14 mijë kujdestarët dhe ndihmësit e tyre. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala gjatë aktivitetit “PAK Art në Pedonale” tha se ky nuk është vetëm një angazhim politik, por një detyrim ndaj qytetarëve dhe një hap i rëndësishëm në rrugën drejt Bashkimit Europian.



► *Shëndetësia 2030: Shërbime të specializuara në spitalet rajonale*

Gjatë bashkëbisedimit me mjekë dhe infermierë në Spitalin Rajonal Lezhë, kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala theksuan rëndësinë e investimeve në spitalet rajonale në infrastrukturë, logjistikë dhe shërbime të specializuara. Gjithashtu, u diskutua menaxhimi efikas i strukturave spitalore dhe mundësia e aplikimit të tarifave shëndetësore për turistët e huaj.



► *Spitali i Kavajës tashmë me status të ri, pjesë e reformës spitalore*

Qendra Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi” Kavajë merr statusin e Spitalit Bashkiak, një hap i rëndësishëm i ndërmarrë në kuadër të reformës spitalore që po aplikohet për decentralizimin e shërbimeve shëndetësore dhe rritjen e aksesit për qytetarët, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të kujdesit për banorët e zonës dhe turistët. Spitali Bashkiak Kavajë, tashmë me ambiente tërësisht të rinovuara dhe kushte bashkëkohore, ofron standarde të përmirësuara infrastrukturore dhe mjekësore për banorët e zonës, rrethinat, si dhe për përballimin e fluksit të shtuar gjatë sezonit turistik.



► ***Siguria e barnave, ministrja Sala: Rrisim standardet në përputhje me legjislacionin e BE-së***

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në Konferencën Mbarëkombëtare të Farmaceutikës, evidentoi reformat e ndërmarra për modernizimin e sistemit farmaceutik, duke synuar ndërtimin e një modeli më transparent, më efikas dhe më të digjitalizuar. Këto ndryshime synojnë rritjen e besimit të publikut, përmirësimin e shërbimit dhe garantimin e një tregu më të qëndrueshëm, ku prioritet kryesor mbetet përmirësimi i aksesit në barna inovative, përmes përsheptimit të procedurave dhe afrimit me praktikat më të mira evropiane.



► *MSHMS prezanton Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale prezantoi Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030, një dokument strategjik që synon të garantojë që romët dhe egjiptianët të gëzojnë të drejta të barabarta, mundësi reale dhe pjesëmarrje të plotë në çdo aspekt të jetës shoqërore. Plani është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të fushës dhe institucione, si dhe është i mbështetur me financim të integruar në buxhet duke garantuar që masat e parashikuara të zbatohen realisht në terren dhe të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së komuniteteve.



Samiti i Diasporës/Paneli i Shëndetësisë: Diaspora, partner i pazëvendësueshëm në transformimin e sistemit shëndetësor shqiptar

Në panelin dedikuar shëndetësisë, në kuadër të Samitit të 4-t të Diasporës zhvilluar në Tiranë, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, theksoi rolin kyç të diasporës shqiptare në avancimin e sistemit shëndetësor në vend dhe ndërtimin e një modeli modern e të qëndrueshëm. Duke vlerësuar diasporën si një nga asetet më të rëndësishme kombëtare, ministrja Sala theksoi se ajo nuk duhet të mbetet vetëm potencial, por të shndërrohet në një partner aktiv në zhvillimin e vendit. Ajo solli në vëmendje disa nga kontributet konkrete të profesionistëve shqiptarë jashtë vendit në fusha si onkologjia, radioterapia, inteligjenca artificiale dhe politikat e financimit të shëndetësisë.



► Firmoset memorandumit për Shëndetin Publik, ministrja Sala: Nuk jemi vetëm reagues, por kontribues në zgjidhje

Shqipëria dhe Italia hedhin një hap të ri në forcimin e bashkëpunimit në shëndetin publik, përmes nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Shëndetit Publik dhe Istituto Superiore di Sanità. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala theksoi se në një botë ku kërcënimet ndaj shëndetit nuk njohin kufij, Shqipëria zgjedh të jetë jo vetëm një vend reagues, por një partner aktiv në ndërtimin e zgjidhjeve dhe forcimin e shëndetit publik.



▶ *Ministrja Sala takon Komisionerin e BE për Shëndetësinë: Vijomë reformat drejt shëndetësisë europiane*


Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, zhvilloi në Bruksel një takim me Komisionerin e BE-së për Shëndetësinë, Oliver Várhelyi, ku u diskutua progresi i Shqipërisë dhe hapat e mëtejshëm në procesin e anëtarësimit, me fokus Kapitullin 28 për shëndetin publik. U theksuan reformat kyçe për forcimin e sistemit shëndetësor, në përputhje me acquis të BE-së, si dhe u vlerësua roli i nismës BE për Shëndetësinë si një hap konkret drejt integritit europian.



► **Gati për verën 2026: 36 qendra shëndetësore verore në shërbim 24/7 për turistët vendas dhe të huaj**

Në prag të nisjes së sezonit turistik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë masat e nevojshme për mobilizimin dhe rritjen e kapaciteteve mjekësore në terren. Këtë verë do të jenë funksionale 36 qendra shëndetësore verore, të shpërndara nga veriu në jug të vendit, të cilat do të ofrojnë shërbim 24/7 për turistët vendas dhe të huaj. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, gjatë inspektimit në Qendrën Shëndetësore Verore Mali i Robit në Durrës, u ndal në rëndësinë e gatishmërisë së sistemit shëndetësor për përballimin e fluksit të shtuar të turistëve, si dhe në garantimin e një shërbimi cilësor dhe në kohë reale për çdo emergjencë shëndetësore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE

BULETINI M U J O R I

PRILL 2026

► **Ministrja Sala: Kërkimi shkencor, inteligjenca artificiale dhe komunikimi me pacientin janë thelbësore për një shërbim cilësor**

Kërkimi shkencor në mjekësi, integrimi i inteligjencës artificiale dhe forcimi i komunikimit me pacientin po konsolidohen si shtyllat kryesore të një sistemi shëndetësor bashkëkohor, ku inovacioni teknologjik rrit ndjeshëm saktësinë dhe efikasitetin e shërbimeve, ndërsa marrëdhënia e besimit me pacientin garanton kujdes më cilësor, të personalizuar dhe njerëzor. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, gjatë fjalës së saj në Kongresin e Dytë Ndërkombëtar të Shkencave Mjekësore, vlerësoi rolin dhe kontributin e profesorëve të përkushtuar, si dhe të brezave të studentëve të talentuar shqiptarë ndër vite, të cilët besojnë në fuqinë e mjekësisë për t'i shërbyer shoqërisë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës

